



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE SIGURSË
PUBLIKE

Nr. 2569/1 prot.

Tiranë, më 13.12.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin *“Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare”*

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj nr.13011 prot., datë 06.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 2569 prot., datë 10.12.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin *“Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare”*, si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së tyre, vërejmë se i njëjti Komision (i parashikuar në projektvendimin *“Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”*) është përgjegjës edhe për vlerësimin e formularit të vetëidentifikimit të plotësuar nga personi që pretendon se i përket një pakice kombëtare, sikurse parashikohet në pikën 2.

Ndërkohë, në pikën 6 citohet: *“Komisioni, në rastin kur nis një procedurë verifikimi kërkon informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për qëllimin e vërtetësisë së të dhënave të paraqitura”*. Për rrjedhojë vlerësojmë se, gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga institucionet e përfshira, të mbahet në vëmendje dhe të respektohet parimi i mjaftueshmërisë së të

dhënave, në përmbushje të një qëllimi të ligjshëm dhe pa e tejkaluar atë, duke marrë masat e duhura teknike dhe organizative të sigurisë së të dhënave, në përputhje me kriteret dhe parimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Gjithashtu, lidhur me formatin e *“Formularit të Vëtëidentifikimit të individit, shtetasit shqiptar që pretendon se i përket një pakice kombëtare”*, të cilin e dërgoni bashkëlidhur projektvendimit, Zyra e Komisionerit sugjeron që në fund të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: *“Të dhënat e grumbulluara nga ky formular, do të përdoren vetëm për përmbushjen e qëllimit fillestar për të cilin ato mblidhen”*.

Sa më sipër, duke reflektuar sugjerimin e bërë nga ana jonë, vlerësojmë se, në tërësi, projektvendimi është hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi